

ANA LALAJ

**KONFERENCA E BUJANIT, 31 DHJETOR 1943 - 2 JANAR 1944,
NJË ANALIZË E RIVLERËSUAR**

Megjithëse kanë kaluar më shumë se 67 vjet kur u mbledh Konferenca e Bujanit, diskutimet dhe shkrimet për të nuk kanë reshtur. Autorët e tyre janë studiues dhe pjesëmarrës të Konferencës, me prirje politike të majta dhe të djathta, me përkatësi etnike të ndryshme, që sipas rastit pohojnë, mohojnë, sulmojnë apo mbrojnë vlerat e Bujanit¹. Sillen kujtime,

¹ Shih: Ali Hadri, "Formimi dhe roli i Këshillit Nacional-Çlirimtar për Kosovë-Metohi", në: *Përparimi*, Prishtinë: 1963, Nr. 9, 10, 11-12; Ali Hadri, *Këshillat nacional-çlirimtare në Kosovë*, Prishtinë: 1974; Ana Lalaj, "Mbi Konferencën e Bujanit", në: *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Tiranë: "Shtypshkronja 8 Nëntori", 1990; Lefter Nasi, Ana Lalaj, "Mbi qëndrimin e udhëheqjes së PKJ dhe PKSË ndaj vendimeve të Konferencës së Bujanit", në *Studime historike*, Tiranë: 1993, Nr. 1-4; Fehmi Agani, "Konferenca e Bujanit dhe mëvetësia e Kosovës", në: *Studime historike*, 1992, Nr. 1-4; Zekeria Cana, "Mbledhja e Mukjes, Lidhja e Dytë e Prizrenit, Konferenca e Bujanit dhe Çështja e Bashkimit kombëtar", në: *Studime historike*, Tiranë: 1992, Nr. 1-4; Ndreçi Plasari, "Politika e udhëheqjes së PKSË dhe e Enver Hoxhës ndaj çështjes së Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore", në: *Studime historike*, Tiranë: 1992, Nr. 1-4; Sami Repishti, "Një qasje për Rezolutën e Bujanit", në: *Konferenca e Bujanit*, Prishtinë: 1998; Jusuf Bajraktari, "Largpamësia e vendimeve të Bujanit", në: *Konferenca ...*; Ramiz Abdyl, "Kontributi i Sali Manit në mbarëvajtjen e punës së Konferencës së Bujanit", në: *Konferenca ...*; Muharrem Dezhgiu, "Operacioni gjerman në Malësinë e Gjakovës", në: *Konferenca ...*; Liri Shimani, "Konferenca e Bujanit dhe Karta e Atlantikut", në: *Konferenca ...*; Izber Hoti, "Administrata Ushtarake akt i dhunës së armatosur kundër mëvetësisë dhe pavarësisë së Kosovës", në: *Konferenca ...*; Fehmi Rexhepi, "Vendimet e Konferencës së Bujanit-Frymëzim për pjesëmarrje aktive të shqiptarëve të Kosovës në Luftën Çlirimtare Antifashiste", në: *Konferenca ...*; Rustem Gjata, "Aspekte politike e juridike të Konferencës së parë të Këshillit Nacional Çlirimtar për Kosovën e Rrafshin e Dukagjinit", në: *Konferenca ...*; Shefqet Hoxha: "Platforma e Bujanit ishte një utopi", në: *Që historia shqiptare të mos mbesë në kurrthën serbo-sllav*, Prishtinë: shtypshkronja Grafobeni, 2011; Sabri Maxhuni Novosella, "Kuvendet, mbledhjet kombëtare 1941-1946 dhe mbledhja e shqiptaro-komunistëve në bashkëpunim me serbo-malazez në Bujan", në: *Që historia shqiptare...*; Abdi Baleta: "Tre libra për një ideal: Bashkimin Kombëtar", në: *Që historia shqiptare...*, etj.

dokumente të papublikuara më parë e, në varësi të tyre bëhen komente dhe interpretime. Në këto rrethana, e pashë të udhës të rivlerësoj edhe një herë Konferencën e Bujanit, pjesëmarrësit dhe vendimet e saj.

Cilat ishin vendimet e Konferencës së Bujanit?

Konferenca e Bujanit, e quajtur ndryshe dhe Konferenca e Parë e Këshillit Nacional Çlirimtar të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit, u mbledh në fshatin Bujan (Bunjaj) të Malësisë së Gjakovës (territori i Shqipërisë së 1913-ës, pothuajse 10 km larg nga kufiri i vjetër me Jugosllavinë), më 31 dhjetor 1943-2 janar 1944. Në Konferencë ishin të pranishëm 49 pjesëmarrës, prej të cilëve 43 shqiptarë, 3 serbë dhe 3 malazezë. Ndërkohë, 12 të ftuar të tjerë nuk erdhën për arsye të ndryshme. Një Kryesi, me kryetar prof. Zekeria Rexha, drejtonte punimet e Konferencës.

Në natën e parë, pas fjalimeve përshëndetëse², iu dërguan telegrame forumeve më të larta të Lëvizjeve Nacional Çlirimtare në Jugosllavi, në Shqipëri dhe në Kosovë.

Ditën e dytë, u mbajtën dy referate, diskutimet dhe u miratua dokumenti kryesor, *Rezolucioni*³, i cili u lexua në gjuhën shqipe dhe serbishtë⁴, dhe u firmos nga të gjithë të pranishmit.

Konferenca zgjodhi *Këshillin Nacional Çlirimtar të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit*, të përbërë nga 42 anëtarë, dhe Kryesinë e Këshillit Krahinor të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit, të përbërë nga Kryetari-Mehmet Hoxha, ish 2 nënkryetarë - Rifat Berisha, ish oficer i ushtrisë

² Arkivi i Institutit të Historisë (më tej: *AIH*), A-VIII-279, Gazeta *Lirija*, Nr. 12,13,14 Nanduer-Dhetuer 1943, Kallnuer 1944, Viti II. Kryetari i Konferencës së Bujanit, Zekeria Rexha, ia dha fjalën me radhë Fadil Hoxhës, Pavle Joviçevićit, Xhafer Vokshit, Sabrije Vokshit, Xhevdet Dodës, Kapitenit Anglez Hans (Fadil Hoxha në kujtimet e tij e quan "Hans", por në fakt ai duhet të ketë qenë Endi Hands (Andy Hendz), komandanti i skuadriljes që vepronte në atë kohë në Kosovë), anëtar i Misionit Britanik pranë UNÇ të Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit, të cilët përshëndetën Konferencën. Më pas u mbajtën dy referate, nga Mehmet Hoxha dhe Xhavit Nimani, rreth të cilëve u zhvilluan diskutimet nga Sadik Bekteshi, Beqir Ndou, Milan Miçkoviç (Milan Mičković), delegati i Drenicës, delegati i Ferizajt, delegati i Pejës dhe delegati i Plavës.

³ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F) 40, viti (më tej: V.) 1944, dosja (më tej: D.) 25.

⁴ *AIH*, A-VIII-279, Gazeta *Lirija*, Nr. 12,13,14, Nanduer-Dhetuer 1943, Kallnuer 1944, Viti II., f. 20.

shqiptare, Pavle Joviçeviç (Pavle Jovičević), punëtor nga Peja, si dhe 6 anëtarë - Zekeria Rexha, ish shef në Ministrinë e Arsimit, nga Gjakova, Xhevdet Doda, drejtor shkollë, nga Prizreni, Fadil Hoxha, mësues, nga Gjakova, Hajdar Dushi, nëpunës banke, nga Prishtina, Në mungesë u zgjodhën edhe 2 anëtarë të tjerë, Milan Zeçar (Milan Zečar), bujk nga Rotkoceri (Ferizaj) e Ali Shukria, student mjekësie nga Mitrovica.

Këshilli Krahinor miratoi *Thirrjen*, një dokument i rëndësishëm, që u drejtohej popujve të Kosovës-shqiptarëve, serbëve dhe malazezëve, për t'u mobilizuar në luftë kundër okupatorëve gjermano-bullgarë dhe gjithë atyre që u shërbejnë.

Sipas Rezolucionit, Këshilli Nacional Çlirimtar i Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit do të ishte “organ i përbashkët ku marrin pjesë të gjitha rrymat politike... pa dallim kombësie, feje, tendence politike e pozite shoqërore”. Ai do të ishte organi më i lartë politik për mobilizimin e popullit të Kosovës në luftën kundër pushtuesit gjerman, por edhe organi më i lartë i pushtetit në krahinë. Këshilli kishte për detyrë të drejtonte punën e këshillave nacional çlirimtarë vartës, të krijuar nëpër fshatrat dhe qytetet e Kosovës, të cilët ishin “organe lufte kundra okupatorit dhe *embrion i pushtetit të ardhshëm* (korsivi im-A.L.)”; “të formojë këshilla të reja nacional çlirimtarë”; “të mobilizojë sa më shumë njerëz në luftë”; “të forcojë edhe më tepër vëllazërimin e popujve tanë (shqiptarë, serbë dhe malazezë)”; “të demaskojë dhe të luftojë okupatorin dhe klikat reaksionare të çdo ngjyre dhe të mos lejojë mobilizimin e popujve tanë në shërbim të okupatorit” etj.⁵ Gjithashtu, Rezoluta shprehej dhe për zgjidhjen e çështjes kombëtare të Kosovës në bazë të parimit të vetëvendosjes dhe përcaktonte rrugën që duhej ndjekur: “Kosova e Rrafshi i Dukagjinit, asht një krahinë e banueme me shumicë nga populli shqiptar, i cili si gjithmon, ashtu edhe sot dëshiron me u bashkue me Shqipnin. Prandaj e ndjejmë për detyrë me i tregue rrugën e drejtë që duhet të ndjekë populli shqiptar për me realizue aspiratat e veta. Rruga e vetme pra që populli shqiptar i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit të bashkohet me Shqipnin ashtë lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorit nazist gjaksor e rrogtarëve të tij, sepse kjo ashtë e vetmja rrugë për me fitue lirinë në të cilën të gjithë popujt, pra edhe populli shqiptar do të kenë mundësi me vetvendosë mbi fatin e tij me të drejtën e vetvendosjes deri në shkëputje. Garancija për këtë ashtë

⁵ AQSH, F. 40, V. 1944, D. 25.

Ushtria Nacional Çlirimtare e Jugosllavisë dhe Ushtria Nacional Çlirimtare e Shqipërisë, me të cilën ngushtësisht asht e lidhun. Përveç këtyne për këtë garantojnë Aleatët tanë të Mëdhenj Bashkimi Sovjetik, Anglija, Amerika (Karta e Atlantikut, Konferenca e Moskës dhe e Teheranit)”⁶.

Për ardhjen, akomodimin, sigurimin ushtarak të zhvillimeve të punimeve të Konferencës së Bujanit, si dhe për përcjelljen e pjesëmarrësve të saj u kujdes organizata e partisë e Gjakovës dhe ajo e Prizrenit, nën drejtimin e Ismet Shaqirit, batalionet “Bajram Curri”, “Perlat Rexhepi”⁷, çeta shoqëruese e Shtabit NÇ të Kosovës, për të cilat përgjigjej Qamil Brovina etj. Konferenca u mblodh në kullën e bajraktarit të Krasniqes, Sali Mani, ndërsa shtëpitë e Qamil Xunës, Xheladin Hanës dhe Ibrahim Muhaxhirit etj., hapën dyert të parat për të pritur delegatët.⁸

Menjëherë pas Konferencës Themeluese, të gjitha materialet e saj (Rezoluta, Thirrja dhe telegramet e përshëndetjes u botuan në gjuhën shqipe e serbokroate, në gazetën “Lirijs-Sloboda”, në numrin e saj që doli nga mesi i janarit 1944, i shumëzuar në disa qindra kopje, pra në numër shumë më të madh se zakonisht. Materialet në fjalë iu dërguan të gjitha komiteteve të Partisë e këshillave nacionalçlirimtarë në Kosovë, si dhe udhëheqjes më të lartë të Partisë Komuniste të Jugosllavisë (më tej: PKJ)⁹, dhe Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH¹⁰ dhe Vukmanoviç Tempos [Vukmanović Tempo] në Maqedoni¹¹.

⁶ *Po aty*.

⁷ *AQSH*, F. 40, V. 1943-1944, D. 8. Në një raport të Kryetarit të Këshillit NÇ të Krasniqes, Veli Niman Doçi, drejtuar Këshillit të Përgjithshëm Antifashist NÇSH më 10 shkurt 1944 shkruhet: “Për Konferencën e Parë NÇ të Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit jemi përpjekur e iu kemi dhënë delegatëve gjithë përkrahjen tonë”.

⁸ Ismet Shaqiri, *Më kujtohet... II, shtator 1943-maj 1945*. Prishtinë: “Rilindja”, 1985, f. 116-121.

⁹ *Po aty*, f. 121. Konferenca caktoi Pavle Joviçeviçin dhe Zekeria Rexhën të shkonin në Mal të Zi për t’u lidhur me udhëheqjen e KQ të PKJ dhe për ta njoftuar për vendimet e marra. Aty ndodhej Ivan Milutinoviç, i deleguari i Shtabit Qendror të UNÇJ dhe i Byrosë Politike të PKJ, në Mal të Zi.

¹⁰ *Zbornik dokumenata i podataka o Narodnooslobodilačkom ratu Jugoslovenskih naroda, Tom I, Knjiga 19. Borbe na Kosovu 1941-1944*. Beograd 1969, dok. 84, f. 390-391. Më 21 janar 1944, Fadil Hoxha, atëherë komandant i Shtabit Kryesor të UNÇJ për Kosovë dhe Metohi, i dërgoi *Rezolutën* dhe *Thirrjen* Shtabit Përgjithshëm të UNÇSH.

¹¹ *Fadil Hoxha në vetën e parë*, redaktor Veton Surroi, Prishtinë: “KOHA”, 2010, f. 198.

**Korniza politike, sociale, ushtarake
kur u mblodh Konferenca e Bujanit**

a) *Platforma e Gjermanisë naziste ndaj Kosovës*

Konferenca Ndërkombëtare e Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha, në Londër (1913), njohu shtetin shqiptar të pavarur, por la jashtë kufijve të tij, Kosovën¹², Çamërinë dhe vise të tjera ku popullsia shqiptare ishte autoktone dhe mbizotëruese. Popullsia shqiptare e Kosovës e aneksuar Mbretërisë Serbe-Kroate-Sllovene, e më vonë Mbretërisë Jugosllave, u trajtua si një popullsi e huaj, e pa të drejta njerëzore e kombëtare. Ndaj saj u zbatua politika e shpërnguljes, e kolonizimit dhe e shfarosjes etnike. Jetesa e shqiptarëve të Kosovës ishte aq e vështirë, sa ata shpreheshin: “Le të na vijë kush të dojë vetëm Jugosllavia të na hiqet qafe”¹³ Kësisoj edhe bashkëjetesa e shqiptarëve me kombet e tjerë në Jugosllavi u kompromentua skajshmërisht. Në këto kushte, populli shqiptar i Kosovës dhe i Dukagjinit apriori do ta quante mik këdo që do të përmbyste këtë gjendje të vajtueshme¹⁴. E tillë ishte situata deri në pushtimin e Jugosllavisë nga ushtritë e Boshtit, në prill 1941.

Kur u thirr Konferenca e Bujanit, Kosova ndodhej nën juridiksionin e shtetit shqiptar të deklaruar “i pavarur”¹⁵, por që në fakt bashkëpunonte me Komandën e Lartë gjermane të pushtimit. “Shqipëria e Madhe” e

¹² Në vitin 1913, me emërtimin “Kosovë” nënkuptohej jo vetëm hapësira e Kosovës së sotme, por edhe trevat e Maqedonisë Perëndimore të Maqedonisë së sotme (Dibra, Struga, etj.).

¹³ *AQSH*, F. 14/AP-PKSH, V. 1943, D. 39.

¹⁴ *AIH*, A-VIII-279, Referati i Mehmet Hoxhës mbajtur në Konferencën e Bujanit.

¹⁵ Kur Shqipëria u pushtua nga Italia fashiste, 7 prill 1939, një “Asamble Kombëtare” e mbledhur me shpejtësi nga italianët, shpalli më 12 prill 1939 “Bashkimin Personal” të Shqipërisë me Italinë, me në krye Mbretin e Italisë, Viktor Emanueli III. (*Fletorja Zyrtare*, Viti XVIII, Nr. 40, 10 qershor 1939), Statuti Themeltar i Mbretërisë së Shqipërisë. Në fakt ky bashkim kurorash që dukej si paqësor, ishte fasada e një pushtimi të vërtetë, pasi me kohë u likuiduan institucionet kryesore të shtetit shqiptar të pavarur, ministria e Jashtme, ministria e Mbrojtjes, ushtria shqiptare etj. Pas kapitullimit të Italisë fashiste dhe hyrjes së trupave të Gjermanisë naziste në Shqipëri, u mblodh përsëri me shpejtësi një “Kuvend Kombëtar” i cili abrogoi vendimin për “Bashkimin Personal” të Shqipërisë me Italinë dhe miratoi një vendim të ri ku Shqipëria shpallej shtet “i pavarur”. (*Fletorja Zyrtare*, Viti XXII, Nr. 106, 23 nëntor 1943. Vendim dt. 22.10.1943, Nr. 1. Neni 1.)

krijuar nga pushtuesit italianë më 12 gusht 1941¹⁶, u ruajt. Një pjesë tjetër e territoreve shqiptare në Maqedoninë Perëndimore ndodhej nën pushtimin bullgar. Qarku i Mitrovicës me rrethinë vazhdoi të jetë i lidhur me shtetin kuisling të Serbisë. Platforma gjermane ishte e mirëstudiuar dhe u ofroi shqiptarëve të Kosovës atë çka atyre u kishte munguar - bashkimin me shtetin amë. Kufijtë u hoqën dhe shqiptarëve të Kosovës iu la hapësirë të ishin të pranishëm ndjeshëm në gjithë jetën politike shqiptare, madje shumë më tepër se sa gjatë pushtimit italian. Në Tiranë, për herë të parë u krijua një qeveri me kryeministër shqiptar nga Kosova, Rexhep Mitrovicën dhe ministra po kosovarë në përbërje të saj: Xhafer Deva (ministër i Brendshëm), Qazim Billaca (zv/ministër i Ekonomisë) dhe Xhelal Mitrovica (sekretar i Përgjithshëm i ministrisë së Kulturës Popullore); në Asamblenë Kombëtare të krijuar në tetor 1943, nga 243 anëtarë - 150 ishin kosovarë¹⁷. Gjithashtu, në Kosovë vazhdonin të funksiononin shkollat shqipe, të shërbenin në administratë nëpunës shqiptarë e të flitej gjuha shqipe, t'u ktheheshin shqiptarëve tokat e marra nga kolonistët serbë e malazezë, të përdorej flamuri kombëtar, pra shqiptarët kosovarë po preknin gjithçka që kishin ëndërruar gjithë jetën. Ndjenjat kombëtare të shqiptarëve u rigjallëruan e u forcuan. Ndodhi një evolucion i shpejtë kombëtar, brenda një kohe shumë të shkurtër, që la gjurmë edhe në vitet e mëpasme. Në këto kushte, shumë shqiptarë të Kosovës, dikur të dhunuar politikisht, ekonomikisht dhe kombëtarisht nga shteti jugosllav, e kishin të vështirë të dallonin ku ndaheshin interesat e tyre nga interesat e vërteta të pushtuesit gjerman. Madje frika ndaj kthimit të së shkuarës do t'i bënte shumë shqiptarë të Kosovës ose indiferentë ndaj Luftës Antifashiste, ose mirëkuptues ndaj Gjermanisë naziste.

b) *Lidhja e Dytë e Prizrenit*

Kushtet skajshmërisht të vështira të shqiptarëve të Kosovës para Luftës së Dytë Botërore, bënë që jo vetëm njerëz të thjeshtë nga populli por edhe intelektualë e personalitete shqiptare me të kaluar patriotike të spikatur, të bashkëpunonin me strukturat politike dhe ushtarake të

¹⁶ *Fletorja Zyrtare*, Nr. 129, 29 gusht 1941. Me Dekretin Mbretëror Nr. 264, dt. 12 gusht 1941-XIX, pjesa më e madhe e Kosovës u bashkua me Mbretërinë Shqiptare dhe u caktuan kufijtë e saj.

¹⁷ N. Plasari, "Politika e udhëheqjes...", f. 82.

Gjermanisë naziste. Në ndërgjegjen e tyre kombëtare dhe njerëzore, pushteti kolonial serb kishte lënë plagë të pashlyeshme. Ashtu si në vitet '20 edhe në vitet '30, shumë nacionalistë shqiptarë vazhdonin të besonin në fjalët e Hasan Prishtinës: “Edhe me djallin për çështjen tonë”¹⁸. Disa prej tyre mendonin se shqiptarët për zgjidhjen e problemit të vet kombëtar, duhej të përfitonin nga politika e pushtuesit, pra nga heqja e kufijve shtetërorë midis Kosovës dhe Shqipërisë londineze dhe të punonin për të mbledhur dokumente që provonin karakterin shqiptar të Kosovës e të ruanin gjendjen ekzistuese deri në mbarim të Luftës. Në këtë mënyrë, në Konferencën e Paqes, fuqitë fituese do të viheshin para faktit të kryer, trojeve shqiptare të bashkuara. Sipas përkrahësve të kësaj ideje, deri në fund të Luftës, shqiptarët duhej t'i bënë ballë vetëm rrezikut sllav, që vinte nga formacionet partizane-komuniste dhe nga ato çetnike.

Në shtator të vitit 1943, kur Italia fashiste kapitulloi dhe situata në Kosovë mund të degjeneronte në anarki administrative dhe politike, nacionalistë të njohur shqiptarë krijuan një organizatë politike-ushtarake, të quajtur “Lidhja e Dytë e Prizrenit”, në nderim dhe analogji me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit të vitit 1878. Në kujtesën e shqiptarëve, emri i kësaj organizate ishte simbol i qëndresës kombëtare kundër pushtuesit të huaj një shekull më parë. Lidhja e Dytë e Prizrenit kishte po të njëjtën qendër, Prizrenin. Qëllimi i organizatës ishte ruajtja dhe mbrojtja e territoreve etnike shqiptare nga Ulqini e Tuzi, në Kosovë e deri në Dibër, Strugë e Prespë, prej një ripushtimi të mundshëm sllav¹⁹.

Për realizimin e synimeve të veta, Lidhja e Dytë e Prizrenit kërkoi ndihmën dhe përkrahjen e autoriteteve gjermane dhe krijoi formacione vullnetare të armatosura që do të stërviteshin nga oficerë dhe nënoficerë të ushtrisë gjermane e të xhandarmërisë²⁰. Sipas Bedri Pejanit, kryetar i Lidhjes, “e vetmja gja për të cilën kjo Kryesi bashkë me të gjithë anëtarët e Lidhjes së Dytë të Prizrenit dëshiron m'u sigurue, asht që Divizioni “Skanderbeg” mos të mundet me i lëshu kufijt e Shqipnisë ethnike e për

¹⁸ Emine Bakalli, “Përpjekjet e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” për të drejtat legjitime të shqiptarëve në Mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene, Jugosllavi”, në: *Çështje nga historia moderne dhe bashkëkohore shqiptare*, Prishtinë: 2011, f. 55.

¹⁹ Tahir Zajmi, *Lidhja II e Prizrenit dhe lufta heroike e popullit për mbrojtjen e Kosovës*, Bruksel: 1964, f. 40.

²⁰ *Po aty*, f. 49.

me shkue diku larg Atdheut shqiptar”²¹. Siç shihet, nacionalizmi i kësaj organizate është një nacionalizëm mbrojtës dhe jo sulmues e pushtues. Megjithatë rreshtimi i krerëve të kësaj organizate me ekstremet politike të kohës, herë me komunizmin rus e herë me Gjermaninë naziste, dëshmon për një lloj çoroditje dhe dobësi në rradhët e tyre. Ka shumë arsye për këtë qëndrim, por nuk mund të shpërfilllet shkëputja politike administrative për disa dekada prej pjesës tjetër të elitës shqiptare, si dhe mungesa e një shteti mik të fuqishëm, të besueshëm e me interesa të përputhshme.

Vështirë të thuash se, drejtuesit e Lidhjes së Dytë të Prizrenit nuk e kishin vënë re rrokullimën e Gjermanisë naziste, e po kështu, se nuk e kishin kuptuar filozofinë e aleancës së të Mëdhenjve, të përbërë nga komunistë, jo komunistë dhe antikomunistë. Por ata nuk besonin se, platforma e thjeshtë e luftës kundër gjermanëve do ta zgjidhte problemin e tyre kombëtar. Për nacionalistët shqiptarë në Kosovë, lufta kundër gjermanëve do të thoshte rikthim i pushtetit serb. Megjithëse historikisht të gatshëm për të mbrojtur trojet e tyre nga pushtuesit e huaj, në vitin 1943 ata preferuan të ruajnë statukuonë e trojeve të bashkuara shqiptare.

Aleatët e Mëdhenj ofronin vetëm platformën e luftës deri në fitore mbi Boshtin dhe asnjë premtim konkret për të ardhmen e Kosovës. Madje, deri në fund të vitit 1942, ata kishin hamendësime për mbijetesën e vetë Shqipërisë si shtet i pavarur dhe qeveria britanike hartonte projekte për copëtimin e mëtejshëm të këtij shteti të vogël e të dobët. Edhe deklarata për rishikimin e kufijve të Shqipërisë në dhjetor të vitit 1942²², nënkuptonte tkurrjen dhe i kishte shqetësuar thellë patriotët shqiptarë kudo që ndodheshin.

Në këtë udhëkryq historik, ku alternativa e bashkimit kombëtar e mbikaloi atë të luftës kundër Gjermanisë naziste, bëri që krerët e Lidhjes së Dytë të Prizrenit të rrëshqisnin në një realitet të hidhur e jo realist. Besimi i tyre se, Lufta nuk do të sillte bashkimin, rezultoi i saktë, por pa luftë e pa zjarr kundër Gjermanisë naziste, ata nuk mund të siguronin asgjë, përveçse një fund tragjik, ashtu si edhe ndodhi.

²¹ *AQSH*, F. 270/23, Lidhja e Dytë e Prizrenit, V. 1943, D. 1, Letër e Bedri Pejanit, kryetar i KQ të Lidhjes së Dytë të Prizrenit dërguar kryeministrit Rexhep Mitrovica, më 31 mars 1944.

²² Reginald Hibbert, *Fitorja e hidhur. Lufta Nacional Çlirimtare e Shqipërisë*, Tiranë: “Shtëpia botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve”, 1992, f. 69.

c) *Lufta dhe vetëvendosja*

Veprimeve ushtarake pushtuese dhe politikës të Boshtit, Aleatët e Mëdhenj iu përgjigjën me një politikë të re. Në gusht të vitit 1941, Kryeministri britanik, Uinston Çërçill (Winston Churchill) dhe presidenti i SHBA, Franklin Rusvelt (Franklin Roosevelt) nënshkruan në brigjet e ishullit Nju Faundlend (New Foundland)²³, Kartën e Atlantikut²⁴, që u kthye në një dokument monumental të mobilizimit të popujve në Luftën Antifashiste.

Karta e Atlantikut ishte një model marrëveshjeje, ku shpaloseshin parimet dhe drejtimit kryesore të politikës që do të ndiqej nga Britania e Madhe dhe SHBA gjatë Luftës dhe pasluftës, megjithëse kjo e fundit akoma nuk kishte hyrë në luftë. Midis këtyre parimeve ishte dhe e drejta e popujve për vetëvendosje. Disa muaj pas Kartës së Atlantikut dhe menjëherë pas hyrjes në Luftë të SHBA, u nënshkrua Deklarata e Kombeve të Bashkuar²⁵. Me këtë deklaratë u hodhën themelet e Aleancës Antifashiste. Firmëtarët e Deklaratës, gjithsej 26, megjithëse shpallnin se

²³ Ishulli New Foundland ishte pjesë e dominionit britanik në oqeanin Atlantik pranë brigjeve të Amerikës Veriore.

²⁴ Kur deklarata e përgatitur nga Rusvelli [Franklin Roosevelt] dhe Çurçilli [Winston Churchill] u transmetua në publik, ajo titullohej "Deklarata e përbashkët e Presidentit dhe e Kryeministrit" dhe u njoh si "Deklarata e përbashkët". Emri "Karta e Atlantikut" besohet se është krijuar së pari nga gazeta *The Daily Herald*, por më 24 gusht 1941, u përdor nga Çurçilli në Parlamentin britanik dhe ky emërtim fitoi popullaritet. Shumë studiues pohojnë se nuk ekziston ndonjë version i nënshkruar si dokument origjinal. Dokumenti u përpunua në disa variante dhe teksti përfundimtar iu transmetua telegrafisht Londrës dhe Washingtonit. Presidenti Rusvelt ia paraqiti Kongresit përmbajtjen e Kartës më 21 gusht 1941. Sipas parimeve të Kartës së Atlantikut: Nuk synohet dhe nuk njihet asnjë zgjerim territorial; ndryshimet territoriale duhet të jenë në përputhje me dëshirat e popujve përkatës; të gjithë popujt kanë të drejtën e vetëqeverisjes (vetëvendosjes); bashkëpunim ekonomik për mirëqënien sociale; ulje e barrierave tregtare; çarmatim i vendeve pushtuese dhe një çarmatim i përgjithshëm i pasluftës etj.

²⁵ Pas hyrjes së SHBA në Luftë, përfaqësuesit e qeverive të 26 shteteve formuan Kombet e Bashkuar Antifashistë, sinonim i Aleancës Antifashiste. Më 1 janar 1942, ata nënshkruan *Deklaratën e Kombeve të Bashkuar*, parimet e së cilës mbështeteshin kryesisht në ato të Kartës së Atlantikut: mosnjohja e asnjë zmadhimi territorial gjatë Luftës e që nuk përputhet me dëshirën e shprehur lirisht të popujve përkatës; rivendosja e vetëqeverisjes (vetëvendosjes) për shtetet që u ishte mohuar me forcë; braktisja e përdorimit të forcës; çarmatimi i shteteve agresore etj.

nuk njihnin ndryshimet territoriale pa pëlqimin e popujve përkatës, problemi mbetej i komplikuar, pasi në fushën e çështjeve kufitare-territoriale nuk luante vetëm një lojtar, por kishte disa popuj-lojtarë apo pretendues. Firmëtarët e Kartës së Atlantikut dhe të Deklaratës së Kombeve të Bashkuar me ndërgjegje iu shmangën trajtimit të problemeve të veçanta politike dhe territoriale të shteteve nënshkruese apo dhe të shteteve të tjerë pjesëmarrës në luftë. Kjo bëhej me qëllim që të arrihej objektivi kryesor, fitorja përfundimtare e Aleatëve mbi Boshtin. Në të kundërtën do të prishej uniteti i koalicionit, dhe, qeveritë, partitë, individët do të merreshin me problemet e veta të çfarëdollojshme, gjë që do të shkaktonte humbjen e pashmangshme të Aleatëve. Në këtë kontekst edhe realizimi i të drejtës së vetëvendosjes u shty për pas Luftës. “Asnjë hap, shkruan zëvendëssekretari i Shtetit, Sumner Welles (Sumner Welles), nuk mund të merrej politikisht, sado fitimprurës mund të ishte ai për më vonë, në qoftë se ai rrezikonte apo kërcënonte të vononte fitoren”.²⁶ Kjo strategji, për të shtyrë vendimet për çështjet politike dhe territoriale, me karakter të pjesshëm ose lokal, pasi të mbaronte Lufta është konsideruar me rëndësi historike, pasi disiplinoi dhe orientoi Aleatët Antifashistë drejt fitores, në rrugën më të mirë të mundshme.

Është interesant të shikosh impaktin që pati te popujt e pushtuar parimi i vetëvendosjes i fiksuar në Kartën e Atlantikut. Karta nuk shpjegonte se në ç’formë konkrete do të realizohej vetëvendosja (si shtet i pavarur, si federatë, apo si njësi autonome), si do të merreshin vendimet (me plebishit popullor apo me përfaqësues në një organ vendim-marrës), cilat ishin tiparet që duhet të zotëronin kombet, kombësitë dhe komunitetet që kishin të drejtë të ushtronin vetëvendosjen. Madje parimi i vetëvendosjes ishte paraqitur në Kartë shumë më zbehtë se në programin e qeverisë së Leninit (tetor 1917), apo në 14 pikat e Uilsonit të shtruar para Senatit amerikan (janar 1918). Megjithatë vetëvendosja u mbështet menjëherë nga forca të djathta e të majta. Në emër të vetëvendosjes ishin shkatërruar perandoritë e mëdha, prej nga ishin krijuar një varg shtetesh të reja në Evropën Lindore dhe Qendrore, si dhe kishte filluar procesi i dekolonizimit. Ishte organizuar Lidhja e Kombeve për të konsoliduar shtetet e reja, për t’i mbrojtur ata dhe paqen midis tyre.

²⁶ Sumner Welles, *Seven Decisions that Shaped History*, New York: “Harper & Brothers Publishers”, 1951, f. 133.

Ky ishte imazhi pozitiv që krijuan shtetet e rinj evropiane për vetëvendosjen uilsoniane.

Më pas, shumë prej këtyre shteteve vuajtën destabilitetin ekonomik, politik, dhe në fund të viteve '30 ranë viktimat të pushtimit nazist. U duk sikur parimi i vetëvendosjes u arkivua. Por fakti që në fillim të Luftës së Dytë Botërore, papritur vetëvendosja u bë shpresa dhe “fjalëkalimi”²⁷ për zgjidhjen e shumë problemeve të trashëguara territoriale, tregoi se trashëgimia pozitive e vetëvendosjes kishte mbijetuar; ndërsa Aleanca e krijuar nga të Mëdhenjtë, bashkëpunimi në luftë midis shteteve dhe popujve, shihej si garancia e realizimit të vetëvendosjes. Por, gjatë luftës çlirimtare kundër pushtuesit, ndjenjat e mbinxitura nacionale dhe shpresat garonin mes tyre, e për rrjedhojë qeveritë, partitë komuniste, grupet politike, individët etj., e panë vetëvendosjen nga optika të ndryshme dhe e përthyen sipas interesave të tyre. Kjo rriti vështirësitë.

Pas prillit 1941, territori i Jugosllavisë u copëtua midis pushtuesve gjermanë, italianë, bullgarë dhe hungarezë. Më 22 qershor 1941, Gjermania naziste sulmoi BS. Po atë ditë, Josif Visarionoviç Stalin (Иосиф Виссарионович Сталин), Sekretar i Përgjithshëm i PKBS dhe Kryeministër i BS thirri në Kremlin Gjergj Dimitrov (Георги Димитров Михайлов), Sekretarin e Përgjithshëm të Kominternit, të cilin e instruktroi për politikën e re që duhej ndjekur. Më 7 korrik 1941, Kominterni u dërgoi të gjitha partive komuniste, midis të cilave dhe PKJ, direktivat për të ndërprerë parrullën e Revolucionit Socialist Botëror; për të filluar në vendet e veta një lëvizje nacionale që do të mishërohej në krijimin e *Frontit Nacional Antifashist*, ku do të merrnin pjesë të gjitha klasat e shtresat e shoqërisë (punëtorë, borgjezë të vegjël, fshatarë, intelektualë etj.) për të luftuar kundër pushtuesit gjerman; për të filluar lëvizjen në mbrojtje të BS të sulmuar etj.²⁸. Pothuajse kudo në Evropën e

²⁷ Margaret Macmillan, *Paris 1919. Gjashtë muaj që ndryshuan botën*, Tiranë: “Plejad”, 2006, f. 25.

²⁸ *The Diary of Georgi Dimitrov, 1933-1949*, New Haven&London: “Yale University Press”, 2003, f. 167; Shih gjithashtu Eduard Mark, “Revolution by Degree: Stalin’s National Front Strategy for Europe, 1941-1947”, *Cold War International History Project*, Washington D.C.: Working Paper, f. 9-10. Në vitet e mëvonshme të Luftës, strategjia e Fronteve Kombëtare u pasurua. Drejtimit kryesorë ishin: krijimi i fronteve nacionale; theksimi i nacionalizmit; parrullat për reforma shoqërore ekonomike të moderuara, jo revolucionare; respektimi i “demokracisë borgjeze”; premtimet për qeverisje efektive; Solidariteti me Aleatët.

pushtuar komunistët u vunë në ballë të rezistencës kundër pushtimit gjerman. Përvoja e gjatë e veprimtarisë ilegale dhe revolucionare i bëri ata shumë efektivë dhe i dha autoritet shumë më tepër se ç'sugjeronte numri i tyre i pakët²⁹. Në përgjigje të direktivave të Moskës, edhe udhëheqja e PKJ deklaroi publikisht se nuk e njihnte copëtimin e Jugosllavisë nga pushtuesit dhe se do të vazhdonte të drejtonte luftën antifashiste nacionalçlirimtare të popujve të Jugosllavisë³⁰.

Në dhjetor 1941, në kuadër të përpjekjeve për të përgatitur Aleancën e madhe të Luftës, Ideni (Anthony Eden), ministri i Jashtëm britanik, u takua me Stalinin në Moskë. Stalini kërkoi që të njiheshin edhe pas luftës kufijtë që BS kishte pasur në momentin e sulmit gjerman, më 22 qershor 1941, kufij që ai i kishte vendosur me forcën e armëve ndaj një vargu shtetesh kufitarë. Fjala ishte për Poloninë Lindore, Besarabinë, Bukovinën Veriore, Lituanië, Estoninë, Letoninë etj. Pavarësisht nga mëdyshjet ndaj kërkesave sovjetike, Perëndimi mbajti një qëndrim pragmatist që u justifikua me interesat e Aleancës për Luftën³¹. Projekt-Programi për rirregullimin e Evropës, i shqyrtuar nga Stalini dhe Ideni, në Moskë, në dhjetor 1941, ndryshoi disa herë në varësi të zhvillimit të Luftës, por fakti që një anëtar i Aleancës mbante dhe do të vazhdonte të mbante me forcë brenda kufijve të tij disa shtete, popujve të cilëve u ishte mohuar vetëvendosja, dëshmonte se germat dhe fryma e Kartës së Atlantikut ishin dhunuar. Vetë BS pas hyrjes në Aleancë, nënshkroi çdo marrëveshje ku premttohej e drejta demokratike e vetëvendosjes për popujt e pushtuar të Evropës. Kështu, të Mëdhenjtë vazhduan të propagandonin parimin e vetëvendosjes dhe popujt që luftonin vazhduan të besonin në të.

Mbështetur në orientimet e Kominternit, PKJ rivendosi lidhjet me të gjithë komitetet vartëse të paraluftës. Lidhjet u rivendosën edhe me Komitetin Rajonal të PKJ për Kosovë e Metohi, i cili që nga viti 1940 kishte qenë nën varësinë e drejtpërdrejtë të KQ të PKJ.³² Qëndrimi i

²⁹ E. Mark, "Revolution by...", f. 8.

³⁰ *Historia e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë*, Prishtinë: "Rilindja", 1985, f. 214.

³¹ S. Welles, *Seven Decisions ...*, f.145.

³² Ana Lalaj, *Politika antishqiptare e PKJ ndaj luftës për vetëvendosje të popullsisë shqiptare në Jugosllavi në vitet 1941-1945*, Tiranë: 1984, f. 22. (Disertacion i depozituar në Bibliotekën Kombëtare dhe në Arkivin e Institutit të Historisë, Tiranë). Konferenca e V e PKJ mbajtur më 19-23 tetor 1940, në Dubrava

Komitetit Rajonal të PKJ për Maqedoninë e Vardarit, e cila pas pushtimit bullgar vendosi të shkëpuste lidhjet organizative me PKJ dhe të përfshihej në PK Bullgare, u trajtua nga Kominterni, i cili vendosi kthimin e Komitetit Rajonal maqedonas nën udhëheqjen PKJ³³. Ndërkohë Kominterni pranonte që komunistët maqedonas “të mbanin lidhje të veçanta edhe me Partinë Komuniste Bullgare”³⁴. Kthimi i Komitetit Rajonal të Maqedonisë në varësi të PKJ u konsiderua si shembull që duhej ndjekur nga partitë e tjera komuniste në rastet analoge.

Në këtë rrjedhë ngjarjesh, në Shqipërinë e pushtuar nga Italia fashiste që në vitin 1939, ekzistonin vetëm grupe komuniste, në grindje e në mosmarrëveshje me njëri tjetrin. Këto grupe u bashkuan dhe krijuan Partinë Komuniste Shqiptare (më tej PKSH) në nëntor të vitit 1941. Delegatët e PKJ, Miladin Popoviç dhe Dushan Mugosha, ndërmjetësuan dhe negociuan me kryetarët dhe anëtarët e grupeve komuniste shqiptare dhe nëpërmjet veprimeve manipuluese arritën që në parti të përfshijnë komunistë pa përvojë politike, me qëllim që t’i formatonin ata siç dëshironin. Që në mbledhjen e themelimit të PKSH pati zëra që e ngritën problemin e Kosovës “pasi tanë Shqipëria asht e okupueme prej këtij problemi”³⁵, që nënkuptonte se kishte një vullnet mbarëshqiptar për t’u

afër Zagrebit miratoi këtë Rezolutë: “Konferenca V Nacionale pranon propozimet e shokëve delegatë nga Metohia dhe Kosova, që organizata e Partisë e këtij rajoni të ndahet nga Mali i Zi dhe që Komiteti Rajonal i Metohisë dhe Kosovës të lidhet drejtpërdrejt me KQ të PKJ”. Nga vjeshta e vitit 1940 deri në Prill - maj 1945, Komiteti Rajonal i PKJ për Kosovën e Metohinë ishte drejtpërdrejt i lidhur me KQ të PKJ.

³³ *Yugoslavia and the Soviet Union, 1939-1973, A Documentary Survey*, redaktor Stephen Clissold, “Oxford University Press”, London, New York, Toronto, 1975, dok. 80, f. 153. Në përgjigjen e Kominternit dërguar KQ të PKJ, në gusht 1941, shkruhet: “Maqedonia duhet të mbetet me Jugosllavinë për shkaqe teknike dhe praktike. Qëllimi kryesor tani është lëvizja partizane. Kjo lëvizje tani është duke u zhvilluar në territorin dhe nën udhëheqjen jugosllave. Maqedonia serbe duhet të bëhet një bazë për këtë lëvizje, duke shqetësuar në shpinë gjermanët dhe italianët në Ballkan...”.

³⁴ *Po aty*.

³⁵ *AQSH*, F 14/AP-PKSH, V. 1942, D. 5, f. 10. Shih letrën e Miladin Popoviçit, përgatitur për t’ia dërguar Kominternit. Në të shkruhet: “Si qëndron çështja e Kosovës? Të kam premtue me të vërtetë me të dhanë përgjigje, ta kam dhanë në dy biseda që kemi pasë, edhe ta kam dhanë përgjigjen në mbledhjen e komunistave në P., vetëm pak në një formë ma të gjanë dhe në formë të një

zgjidhur kjo çështje. Kosova ishte një problem i trashëguar etnik, territorial e nacional që nga fillimshekulli dhe shumica e shqiptarëve, ashtu si popujt e tjerë të ndarë, aspironin të bashkoheshin duke vënë në jetë parimin e vetëvendosjes të propaganduar gjatë Luftës. Por si në këtë mbledhje, ashtu edhe gjatë gjithë Luftës, problemi i Kosovës mbeti pezull, pasi PKSH dhe PKJ, megjithëse dy parti miqësore me njëra tjetrën nuk kishin program konkret për Kosovën. Propaganda që bëhej për Kosovën ndryshonte në varësi të ecurisë së Luftës dhe synimeve politike për pasluftën nga të dyja partitë. Gjithsesi, në raportin PKSH-PKJ, partia shqiptare ishte e re dhe nën ndikimin e vazhdueshëm të PKJ, gjë që përcaktoi dhe zgjidhjen e problemit të Kosovës sipas strategjisë së PKJ për çështjen kombëtare: ngritjen e Jugosllavisë Federative me kufij më të zgjeruar se të paraluftës.

Në nëntor të vitit 1943, në Konferencën e Dytë të AVNOJ³⁶-t, në Jajcë të Bosnjës, vetë Josip Broz -Tito³⁷ do ta shfrytëzonte parimin e të drejtës së vetëvendosjes në funksion të strategjisë për ruajtjen e Jugosllavisë. Thelbi i AVNOJ-t ishte Jugosllavia e bashkuar mbi baza federative, kurse vetëvendosja ishte vetëm fasada. Megjithëse Rezoluta e AVNOJ-t shprehej se vendimi për Jugosllavinë federative merrej “në bazë të së drejtës së çdo populli për vetëvendosje, duke përfshirë të drejtën për shkëputje ose bashkim me popujt e tjerë”, vetëvendosja u trajtua në mënyrë të njëanshme, vetëm në sensin e bashkimit dhe e tillë mbeti ajo deri në shpërbërjen e Jugosllavisë, në vitin 1991 -1992. E vërteta është se vetëvendosja deri në shkëputje e popujve nuk u vu asnjëherë në provë në Jugosllavinë federative komuniste. Për më tepër, për ato popullsi që nuk patën përfaqësuesit e tyre në AVNOJ, nuk mund të flitej për vetëvendosje, pra as për shqiptarët në Jugosllavi. Vendimet e Mbledhjes

bisedimi nervoz të shkaktuem nga pyetja që u ba. E në qoftëse do të pyetet se kush e ka ba këtë pyetje, po të them se e kan ba Dinoja [Koço Tashko] e Tafari [Mustafa Gjinishi], tue thanë se tanë Shqipnija asht e okupueme prej këtij problemi etj”. Shih gjithashtu Kristo Frashëri, *Historia e së majtës në Shqipëri dhe e themelimit të PKSH-së 1878-1941*, Tiranë: “Ilar”, 2006, f. 259-262. Sipas profesor Kristo Frashërit, problemi i Kosovës u ngrit jo vetëm nga Koço Tashko e Mustafa Gjinishi por edhe nga Anastas Lulo.

³⁶ AVNOJ - Antifašističko Veće Narodnog Oslobođenja Jugoslavije, Këshilli Antifashist Nacional Çlirimtar i Jugosllavisë.

³⁷ “Tito” ishte pseudonim i Josip Broz-it që në vitet e Luftës së Dytë Botërore. Ai e mbajti këtë emërtim edhe pas Luftës.

së Dytë të AVNOJ-t i dhanë fund dilemës së tërësisë territoriale të Jugosllavisë, e në këtë kuadër dhe të përfshirjes së shqiptarëve në Federatën e Sllavëve të Jugut.

Këshilli Nacional Çlirimtar i Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit - organi kryesor i mëvetësisë së Kosovës

a) Në prag të mbledhjes së Bujanit

Në vitet e Luftës së Dytë Botërore, për shqiptarët e Kosovës zgjidhja e çështjes kombëtare të trashëguar nga historia mbetej çështja kryesore. Qëndrimi ndaj saj përcaktonte dhe aleatët me të cilët do të luftohej për të arritur këtë qëllim e për t'u rreshtuar në krahun e duhur, në krah të Koalicionit Antifashist. Nëse përballë platformës gjermane të bashkimit kombëtar do të shpalohej nga Aleatët e Mëdhenj një alternativë tjetër e besueshme që t'u dëshmonte shqiptarëve se po i çonte drejt zgjidhjes së çështjes së tyre kombëtare, do të ndikonte në mënyrë vendimtare në zhvillimin e fuqishëm të luftës.³⁸ Po kështu, nëse do të bëhej kjo nga forca politike që drejtonte Luftën Antifashiste në Kosovë, PKJ, atëherë ushtria gjermane do të konsiderohej ushtri pushtuese dhe do të luftohej kundër saj.

Por dokumentet provojnë se në Luftën e Dytë Botërore, PKJ nuk e konsideronte zgjidhjen e problemit kombëtar shqiptar si rezultat i Luftës. J.B.Tito dhe udhëheqja jugosllave ishin të predominuar nga ideja e ruajtjes së Jugosllavisë, madje nga zmadhimi i saj. Prandaj traktet dhe deklaratat e udhëheqësve të PKJ, edhe kur përmendnin vetëvendosjen e shqiptarëve në Kosovë e Jugosllavi, ishin plot ekuivoqe, të mjegullta, të përgjithshme e aspak shpjeguese. Për rrjedhojë "ndikimi i PKJ te shqiptarët ishte i dobët"³⁹, Ndërsa në terren, politika e PKJ ishte mosbesuese dhe sektare ndaj tyre⁴⁰. Në strukturat drejtuese partiake dhe ushtarake të Kosovës përfaqësimi i shqiptarëve ishte minimal⁴¹.

³⁸ A. Lalaj, *Politika antishqiptare...*, f. 22.

³⁹ *Zbornik...*, Tom I, *Knjiga 19*. dok. 19, f. 113. Rezoluta e Komitetit Krahinor PKJ për Kosovë Metohi, në korrik 1942.

⁴⁰ *Po aty*, dok. 32, f. 189. Mbledhja e Komitetit Krahinor të PKJ për Kosovë Metohi, më 2 dhjetor 1942.

⁴¹ Ali Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë, 1941-1945*, Prishtinë: 1971. f. 48, 171. Komiteti Krahinor i PKJ për Kosovën e Metohinë përbëhej nga 15 anëtarë ku vetëm 4 prej tyre ishin shqiptarë, ndërsa në Shtabin Kryesor për Kosovën e Metohinë, nga 5 anëtarë, vetëm 1 ishte shqiptar, kryetari i tij Fadil Hoxha.

Nga ana tjetër edhe shqiptarët nuk u joshën nga politika e PKJ, madje edhe traktet me siglën e PKJ në fund, të lëshuara nga komitetet partiakë të rretheve⁴² refuzonin t'i lexonin. Komunistë nga rrethet kërkonin që të hiqej fjala “Jugosllavi”, se populli e urrente.⁴³ Për shqiptarët e Jugosllavisë, komunistët serbë nuk ishin më të mirë se serbët mbretërorë apo çetnikët. Ndryshimi i ideologjisë nuk kishte rezultuar në një mentalitet dhe qëndrim miqësor proshqiptar⁴⁴. Sloganet boshe për çlirim ishin të pamjaftueshme që shqiptarët e vuajtur e të masakruar në Mbretërinë jugosllave të ngriheshin në luftë. Disa çeta partizane, si aradha “Emin Duraku” dhe aradha “Zenel Hajdini”, ishin përbërë nga një numër i vogël luftëtarësh. Formacionet e mëdha ushtarake mungonin. Lidhja e Dytë e Prizrenit, pavarësisht se nuk kishte arritur atë çka synonte, gëzonte reputacion në popullsinë shqiptare si mbrojtëse e territorit të njësuar shqiptar. Ishin të gjitha këto rrethana që e vonuan zhvillimin e Lëvizjes Antifashiste Nacional Çlirimtare në Kosovë.

Por, kur sukseset politike dhe ushtarake të lëvizjeve nacionalçlirimtare në Jugosllavi dhe në Shqipëri u bënë të dukshme, kur Italia fashiste kapitulloi, ushtria gjermane u thye përpara portave të Stalingradit, Ushtria e Kuqe filloi mësymjen drejt Evropës dhe lajmet për fitoret e Koalicionit Antifashist në teatrot e mëdha të Luftës po përhapeshin me shpejtësi, atëherë edhe në Kosovë ndodhën zhvillime të reja. Udhëheqja lokale e PKJ e pa të udhës t'u kushtonte më shumë kujdes shqiptarëve duke i përfshirë edhe ata në forumet e luftës. Njëkohësisht kjo ishte edhe një nevojë e drejtuesve komunistë të Kosovës për të afirmuar veten. Kur në Jugosllavi ishin krijuar këshillat krahinorë nacionalçlirimtarë, një këshill nacionalçlirimtar i tillë edhe për Kosovën, ku shumica të ishin shqiptarë, do të ndikonte në zhvillimin pozitiv të luftës kundër gjermanëve. Në të njëjtën kohë do të përdorej si kundërpeshë edhe ndaj Lidhjes së Dytë të Prizrenit, e cila bashkëpunonte ngushtë me Komandën e Lartë gjermane, por kishte në dorë kartën e së vërtetës për çështjen shqiptare, të cilën e lexonte dhe e zbatonte hapur, pavarësisht nga mjetet dhe rrugët: bashkimi i pjesës më të madhe të trojeve shqiptare pa kufij ndarës midis tyre.

⁴² *Po aty*, f. 33, 61.

⁴³ *AQSH*, F.14/AP-PKSH, V. 1942, D. 135; Shih gjithashtu: Lefter Nasi “Kosova dhe problemi kombëtar në vitet 1941-1943”, në: *Studime historike*, Nr. 3-4, Tiranë: 2003, f. 92.

⁴⁴ Arshi Pipa, *Stalinizmi shqiptar*, Tiranë: “IKK&Princi”, 2007, f. 153.

Nuk është e rastit që kësaj radhe komunistëve shqiptarë iu la hapësirë më shumë se kurdoherë tjetër, për të ftuar simpatizantë shqiptarë të Luftës Antifashiste, në një forum të rëndësishëm krahinor, siç ishte Këshilli Nacionalçlirimtar i Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit që do të krijohet. Ky qëllim për të aktivizuar shqiptarët duket qartazi dhe në një letër që Miladin Popoviçi i dërgon Pavle Joviçeviçit, disa ditë para Konferencës së Bujanit: “Ti ke të drejtë kur thua se suksesi i Luftës sonë varet shumë edhe nga Kosova. Është e qartë se jo vetëm që varet por Kosova luan një rol vendimtar në luftën tonë. Kështu, në qoftë se armiku do të arrinte të mobilizonte kosovarët (nënkupto shqiptarët-shënimi im, A.L.) kundër luftës sonë, atëherë ne do të ishim në një gjendje të rëndë, kritike. Por në qoftë se kosovarët nuk ngrihen kundër nesh, ne do të mundim në Shqipëri t’i japim goditje reaksionit...”⁴⁵

b) *Bujani përballë Jajcës*

Udhëzimi për krijimin e Këshillit NÇ për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit u dha në fillim të nëntorit 1943, kurse Mbledhja e Dytë të AVNOJ-t u mbajt në fund të të njëjtit muaj. Në literaturën historiografike shqiptare ekziston mendimi se pjesëmarrësit e Konferencës së Bujanit ishin plotësisht të informuar për vendimet e Mbledhjes së Dytë të AVNOJ-t. Personalisht e kam të vështirë të vlerësoj me saktësi se, në ç’shikallë ishin të informuar drejtuesit krahinorë të Kosovës dhe vetë pjesëmarrësit e Konferencës për vendimet e AVNOJ-t. Megjithatë do përpiqem të ndjek zhvillimin e ngjarjeve nëpërmjet disa dokumenteve të kohës:

Së pari, në Konferencën e Dytë të AVNOJ-t nuk morën pjesë përfaqësues nga Kosova. Në raportin e Todor Vujasinoviçit (Todor Vujasinović), i paraqitur në emër të Këshillit verifikues, në Konferencën e Dytë të AVNOJ-t, flitet për praninë në mbledhje të delegatëve nga Kroacia, Bosnjë-Hercegovina, Vojvodina, Serbia, Mali i Zi e Boka, Sllovenia, theksohet se nuk kishin mundur të mbërrinin delegacioni nga Maqedonia dhe Sanxhaku, ndërsa për përfaqësuesit e Kosovës nuk u tha asnjë fjalë⁴⁶. Ekziston edhe një variant tjetër se “përfaqësuesit nga

⁴⁵ Spasoje Gjakoviç (Spasoje Đaković), *Sukobi u Kosovu*, Beograd: “Narodna Knjiga”, 1984, f. 404. Letra e Miladin Popoviçit (Miladin Popović) dërguar Pavle Joviçeviçit (Palokës) më 5 dhjetor 1943.

⁴⁶ Kurtesh Saliu, “Autonomia e Kosovës e lidhur ngushtë me krijimin e pushtetit revolucionar”, *Rilindja*, 27 dhjetor 1983.

Kosova nuk e ndoqën Konferencën e Dytë të AVNOJ-t pasi nuk kishin komunikim të rregullt me Komitetin Qendror dhe Komandën e Shtabit NÇ të Jugosllavisë⁴⁷.

Së dyti, radiostacioni “Jugosllavia e Lirë”⁴⁸, me qendër në Moskë, në dhjetor 1943 e kishte dhënë lajmin për Konferencën e Dytë të AVNOJ-t, por vendimet për krijimin e Federatës Jugosllave dhe të qeverisë jugosllave të Frontit Nacionalçlirimtar u censuruan me porosi të Stalinit⁴⁹. Ndërsa vetë Tito, vendimet për përfshirjen e bregdetit slloven,

⁴⁷ Radošin Rajović, “Emergence and Development of the Autonomy of Kosovo within Serbia and Yugoslavia”, në: *Relationship Between Yugoslavia and Albania*, Review of International Affairs, Belgrade: 1984, f. 62. Sipas asaj që Mita Milkoviç (Mita Milković), atëherë Komisar politik i Brigadës shqiptare-maqedonase, i ka thënë historianit Radošin Rajović, autorit të artikullit, emrat e delegatëve nga Maqedonia dhe Kosovë Metoija do të duhej të jepeshin me anën e radios së Shtabit të Përgjithshëm për Maqedoninë. Por radio u prish gjatë transmetimit dhe vetëm 3 emra u transmetuan (Dimitar Vlahov, Vlado Poptomov, Mihajlo Apostolski).

⁴⁸ Radiostacioni “Jugosllavia e Lirë” me qendër në Moskë u krijua nga Kominterni në vitin 1941, pas sulmit të Gjermanisë naziste kundër BS, për të nxitur mobilizimin e popujve jugosllavë në Luftë.

⁴⁹ Josip Broz Tito, *Vepra 8, Fjalime dhe artikuj*, Prishtinë: 1964, f. 414. Tito synonte të shpallte qeverinë jugosllave dhe Federatën jugosllave që në Mbledhjen e Parë të AVNOJ-t në Bihaçe, por sovjetikët e refuzuan duke iu përmbajtur marrëveshjeve me Aleatët e Mëdhenj të Luftës: “Unë i kam pyetur ata (sovjetikët) dhe në rastin e Bihaçit dhe patën thënë “Jo” dhe ne atëherë nuk patëm mundësi ta bëjmë këtë gjë”.

Përgjigja e Kominternit dërguar Titos në prag të Mbledhjes Parë të AVNOJ-t ishte: “Ju duhet t’i jepni Komitetit Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë një karakter mbarë kombëtar jugosllav dhe një karakter gjithëpërfshirës partish antifashiste, edhe në përbërje edhe në programin e punës. Mos e konsideroni Komitetin si një lloj qeverie, por si një armë politike të luftës nacionale për çlirim. Mos e vendosni atë në opozicion me qeverinë jugosllave në Londër. Në momentin e tashëm mos e ngrini çështjen e abrogimit të Monarkisë. Mos paraqisni ndonjë slogan për republikë. Çështja e regjimit në Jugosllavi, siç ju e kuptoni atë, do të dalë pasi koalicioni italo-gjerman të jetë shpartalluar dhe vendi të jetë i lirë prej pushtuesve”. (Shih gjithashtu: *Yugoslavia and the Soviet Union, 1939-1973, A Documentary ...*, dok. 75. f. 150).

Për zemërimin e Stalinit dhe censurimin e lajmit mbi Konferencën e Dytë të AVNOJ-t, Velko Vllahoviç (Veljko Vlahović), përfaqësuesi jugosllav që punonte në Radiostacionin “Jugosllavia e Lirë”, në Moskë, dëshmon: “Dimitër Manuilski (udhëheqës i lartë sovjetik - Ukrainë) më tha se “Deda [Stalini] është shumë i

të Sllovenisë beneshke, të Istriës dhe të ishujve kroatë të Adriatikut - Jugosllavisë federative⁵⁰, nuk ia bëri të njohur Stalinit, pasi ato vendime mbaheshin sekret si ndaj tij ashtu dhe ndaj Aleatëve⁵¹. Për përmbajtjen e plotë të vendimeve të AVNOJ-t në Jajcë u mësua vetëm nga mesi i pranverës të vitit 1944⁵².

Po kështu, në prag të Konferencës së Bujanit, vendimet e Konferencës së Dytë të AVNOJ-t nuk u ishin dërguar as Komitetit Krahinor dhe as Shtabit Ushtarak të Kosovës. Nga dokumentet del se, asnjë nga drejtuesit krahinorë nuk ishte informuar plotësisht mbi Konferencën e Dytë të AVNOJ-t, madje as Pavle Joviçeviçi, i cili ishte i vetmi që mbante lidhjet e Komitetit Krahinor me KQ të PKJ. Kështu, në një letër drejtuar KQ të PKJ në fund të janarit 1944, Pavle Joviçeviçi shkruan: “Nuk i kishim materialet dhe nuk dinim për konferencat në Sanxhak, Bosnje Hercegovinë dhe Mal të Zi. Po ashtu nuk kishim as materialet ndihmëse ose materiale të tjerë të ngjashëm. Morëm parasysh kornizën kuadër të Këshillit Nacional Çlirimtar, se pse çështjen e Këshillit (Këshilli NÇ si

zemëruar. Ai [Stalini] tha se kjo [vendimet e Konferencës së Dytë të AVNOJ-t] është një thikë në shpinë të BS dhe vendimeve të Teheranit”. Ne na u tha se mund ta transmetonim lajmin për mbledhjen e Jajcës, por asnjë fjalë për vendimet. Gjithçka që na u lejua ne ishte të përsërisnim vendimet e mbledhjes së Parë të AVNOJ-t”. (Shih gjithashtu: Vladimir Dedijer, *Dokumenti, Knjiga Prva*, Beograd: “Rad”, 1979, f. 14-16).

⁵⁰ *Po aty*, f. 21.

⁵¹ A. Lalaj, *Politika antishqiptare ...*, f. 75-77. Vladimir Bakariç, një nga drejtuesit kryesorë të Luftës në Kroaci shprehet: “Duhet të them se vendimet e sakta që duhej të merrte AVNOJ, i fshihnim nga rusët, i fshihnim nga bota”. (shih: Vladimir Bakariç, “Kako smo radili i gde smo sada”, gazeta *Nin*, Nr. 1035, 8 nëntor 1970). Vendimi që u mbajt i fshehur ishte ai mbi tërësinë territoriale të Federatës Jugosllave.

Edhe referati i J.B.Titos i mbajtur në Konferencën e Dytë të AVNOJ-t u bë publik në vitin 1953, kur u botua për herë të parë në librin *Odluke Drugog Zasjedanja Antifašističkog Vijeća Narodnog Oslobođenja Jugoslavije*. Më vonë u botuan dhe materialet e tjera të Konferencës së Dytë të AVNOJ-t. (shih: *Zbornik dokumenata i podataka o Narodnooslobodilačkom ratu Jugoslovenskih naroda, Tom II, Knjiga 11, Dokumenta Vrhovnik Štaba Narodnooslobodilačke Vojske Jugoslavije 1943-1944*, Beograd: 1963).

⁵² Coła Dragoiçeva (Цола Драгойчева), *Из моите спомени. На класови и интернационалистически позиции*. (Nga kujtimet e mia), Софиа: “Партиздат”, 1979.

trup legjislativ që formua në Jajcë-shënimi im A.L.), ku e si u formua nuk e dinim”⁵³. Është kjo arsyeja që në diskutimet e delegatëve të Konferencës së Bujanit, në Rezolutën e miratuar prej saj dhe në Thirrjen drejtuar popujve të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, kur përmendet Konferenca e Dytë e AVNOJ-t nuk jepen detaje për vendimet e AVNOJ-t.

Dokumentet kryesore, Rezoluta, Thirrja, telegramet, siç ndodh zakonisht në konferenca të rëndësishme, u përgatitën më parë se të fillonte Konferenca Themeluese e Këshillit. Për këto materiale ka punuar Mehmet Hoxha, Pavle Joviçeviç, Ismet Shaqiri, Zekeria Rexha⁵⁴ etj. Gjatë zhvillimit të Konferencës ka pasur debate sidomos rreth çështjes së të drejtës së vetëvendosjes të popullit shqiptar dhe zbatimit të saj. Edhe Pavle Joviçeviçi e pranon në kujtimet e tij se “ka pasur diskutime të ashpra” në Konferencë. Ai pohon se “kishte qenë dakord më parë me çfarë përfshihej në dokumentet e konferencës”, por nën presionin e diskutimeve “dokumentet u rishkruan në një formë kompromisi”. “Kosmeti”⁵⁵ mbeti diçka e varur (e papërcaktuar) ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë”⁵⁶.

Praninë e kësaj atmosfere në Konferencë na e sjell edhe një dokument tjetër, përsëri nga kujtimet e bashkëkohësve. Sami Peja, atëherë komisar i kompanisë shoqëruese të Shtabit NÇ të Kosovës, tregon: “Zekeria Rexha, Hajdar Dushi e Xheladin Hana punonin në dhomën e poshtme të kullës së Sali Manit. Unë isha para derës së kësaj kthine, kur dëgjova zërin e ngritur të Hajdarit [Dushi] që iu drejtua afërsisht kështu Pavle Joviçeviçi: “Në qoftë se nuk e nënshkruani Rezolucionin në këtë version, ne do t’i ndajmë shqiptarët dhe kufirin do ta vemë qysh tashti”. Vrapova te Fadil Hoxha në Shtab dhe njoftova se për “diçka nuk po merren vesh shokët”. Ai erdhi bashkë me Shefqetin (pseudonimi i Milan Miçkoviçi - Milan Mičković), dhe, i pajtoi disi”⁵⁷.

⁵³ *Zbornik...*, Tom I, Knjiga 19, dok. 93, f. 420.

⁵⁴ I. Shaqiri, *Më kujtohet... II...*, f. 117; *Fadil Hoxha në vetën ...*, f. 194.

⁵⁵ Kosmet është shkurtimi i emrave “Kosovë e Metohi”. Ky emërtim përdorej nga serbët dhe malazezët, kurse shqiptarët përdornin emërtimin “Kosovë”, ose “Kosovë dhe Rrafsh i Dukagjinit”.

⁵⁶ R. Rajović, “Emergence and ...”, f. 66.

⁵⁷ Sami Repishti, “Rezoluta e Bujanit 2 janar 1944: Një analizë”, në *Studime historike*, Tiranë: 1995, Nr. 1-4, f. 94, përmendur sipas: Vehap Shita, “Zekeria Rexha”, *Bujku*, Prishtinë: 29 dhjetor 1991, f. 9.

Këto dëshmi lënë të kuptosh se debatet janë zhvilluar kryesisht për zgjidhjen e çështjes kombëtare në Kosovë, dhe, se ishte vullneti i përfaqësuesve të konferencës që imponoi ndryshimin e dokumenteve të përgatitura paraprakisht. Është e kuptueshme se, trajtimi që është bërë në Rezolutë është konform parimeve të Kartës së Atlantikut, por jo në përgjigje të vendimeve të marra në Konferencën e Dytë të AVNOJ-t. Edhe sot pas 67 vjetësh nuk mund të gjendet një formulë që të shprehë më parimisht dhe më funksionalisht në kushtet e Luftës të drejtën dhe realizimin e vetëvendosjes për një popull të pushtuar.

Rezolutën e Konferencës Themeluese të Këshillit Nacional Çlirimtar të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit e firmosën të gjithë pjesëmarrësit, që në mbledhje ishin kthyer në anëtarë të Këshillit të ri. Pra, me vullnet të lirë, të gjithë i pranuan të gjitha vendimet. Në një letër që Pavle Joviçević ia dërgon Tempos më 12 janar 1944, shkruan: “Pas përgatitjeve dhe një pune të gjatë arritëm të organizojmë dhe të mbajmë me sukses Konferencën [e Bujanit]. Punimet e Konferencës, vendimet dhe diskutimet ishin të mira, madje më të mira se ne i prisnim. Në Konferencë është marrë vendim që të dërgojmë dy delegatë në Komitetin Nacional të Këshillit Antifashist [të Jugosllavisë], si dhe një delegat në Këshillin Nacional-Çlirimtar të Shqipërisë. Këto vendime i morëm për efekt politik. Duhet përpjekur që në Shqipëri të shkruhet sa më shumë për konferencën tonë”.⁵⁸

Por, pikërisht në këtë moment ndodh edhe një lloj reflektimi në veprimtarinë e Pavle Joviçevićit. Në janar 1944, ai ka marrë dy letra të Tempos, të shkruara më 2 tetor dhe më 25 nëntor 1943. Në to, Tempo kritikon Komitetin Krahinor të Kosovës se në veprimtarinë e tyre të deriatëhershme ata “kanë rënë nën ndikimin e klikës shqiptaromadhe lidhur me kufijtë e ardhshëm ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë”⁵⁹ dhe se “duket qartë se ju në Kosmet i trajtoni gjërat në linjën shqiptaromadhe”⁶⁰. Nisur nga fakti se në hierarkinë komuniste disiplina në zbatimin e urdhrave është shumë e rreptë dhe qëndrimi ndryshe penalizohet rëndë, kemi arsye të mendojmë se këto kritika të Tempos kanë ndikuar te Pavle Joviçević për të rivlerësuar vendimet e Bujanit. Më

⁵⁸ Zbornik..., Tom I, Knjiga 19, dok. 81, f. 383, 12 janar 1944.

⁵⁹ Zbornik dokumenata i podataka o Narodnooslobodilačkom ratu Jugoslovenskih naroda, Tom II, Knjiga 10, Dokumenta Vrhovnog Štaba Narodnooslobodilačke vojske Jugoslavije, 1943, Beograd: 1962, dok. 161, f. 339.

⁶⁰ Po aty, Tom II, Knjiga 11, Beograd, 1963, dok. 71, f. 127.

31 janar 1944, ai i shkruan një letër KQ PKJ, ku pasi informon për situatën politike, ushtarake dhe organizative në Kosovë, lajmëron për krijimin e Këshillit Nacional Çlirimtar të Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit, organizimin dhe vendimet e tij. Ai pohon se, në to “kanë kaluar disa lëshime dhe të meta, por në situatën në të cilën ishim nuk mund të bëhej ndryshe”. Prandaj P. Joviçeviç e quan të nevojshme që “Këshilli Antifashist NÇ i Jugosllavisë ose Komiteti Kombëtar i Jugosllavisë t’i shkruajë Këshillit tonë e t’i tregojë të gjitha gabimet, mungesat dhe dobësitë”⁶¹.

c) *Goditja ndaj mëvetësisë*

Përgjigja e KQ të PKJ erdhi më 28 mars 1944, nëpërmjet një letre të firmosur nga Milovan Gjlasi⁶². Letra ishte edhe pohuese, edhe kritikuese, edhe mohuese. Gjithsesi në thelbin e saj dukej qartë se, udhëheqësit jugosllavë ishin të irrituar nga vendimet e Konferencës së Bujanit. Megjithatë në letrën e KQ të PKJ, do të veçoja vetëm dy momente:

- a) Minimizimi i Këshillit NÇ të Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit si një këshill “iniciator” që sipas letërshkruesit “nuk duhej t’i jepej karakter pushteti” por vetëm funksione politike të Luftës.
- b) Goditja shkatërrimtare që letra i dha aspiratës së popullit të Kosovës për bashkim kombëtar me Shqipërinë.

Krijimi i Këshillit Nacional Çlirimtar të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit i themeluar në Konferencën e Bujanit, plotësonte strukturën e Kosovës si një njësi e veçantë në Jugosllavi, me organet e saj krahinore të partisë, të ushtrisë dhe të pushtetit, që vareshin drejtpërsëdrejti nga organet qendrore përkatëse jugosllave. Ky këshill vuri themelet e mëvetësisë së Kosovës dhe ishte organi drejtues që i përgjigjej më mirë se çdo organ tjetër drejtues raporteve etnike në Kosovë. Ndryshe kishte ndodhur me Komitetin Krahinor të PKJ në Kosovë, ku kishte vetëm 4 shqiptarë nga 15 anëtarët e tij, kurse në Shtabin Ushtarak kishte vetëm 1

⁶¹ *Zbornik..., Tom I, Knjiga 19*, dok. 93, f. 420. Pavle Joviçeviç përmend mungesën e informacionit për zhvillimet politike në Jugosllavi, (Sanxhak, Bosnjë Hercegovinë e Mal të Zi) si dhe mungesën e materialeve ndihmëse për krijimin e këshillit. “Morëm kornizën e Këshillit NÇ, sepse për çështjen e komitetit (qeverisë), si dhe ku u formua nuk e dinim”.

⁶² *Po aty*, dok. 105, f. 467-476.

shqiptar nga 5 anëtarët e tij. Këshilli Nacional Çlirimtar i Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit me prerogativa pushteti dhe në shumicën e tij me shqiptarë, ende i sapo lindur po i krijonte kokëçarje udhëheqjes së lartë jugosllave. Pas Luftës, ai do të kërkonte të zbatohet Rezoluta e Bujanit, që ishte në kundërshtim të plotë me vendimet e AVNOJ-t dhe me strategjinë e PKJ për Jugosllavinë.

Prandaj goditja e udhëheqjes jugosllave u drejtua në dy vatra: *e para*, në zhvlerësimin e minimizimin e vetë Këshillit NÇ të Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit, dhe *së dyti*, në asgjësimin e “nervit kryesor të Rezolutës”⁶³, zgjidhjes së çështjes kombëtare, që ishte dhe detyrimi kryesor i këtij këshilli. Autori i letrës së 28 marsit 1944 përpiket me mjeshtri të kamuflonjë qëndrimin e vërtetë të PKJ, duke kërkuar që të popullarizohen vendimet e AVNOJ-t, domethënë, vendime ku shqiptarët nuk përmenden; tërheq vëmendjen se “sot nuk është puna që të vendosen kufijtë e Shqipërisë dhe të Jugosllavisë, që të dyja të pushtuara nga gjermanët, por që të dyja këto me armë në dorë të çlirohen prej tyre”. Sot, që kemi në dorë dokumentet për vendimet e Konferencës së Dytë të AVNOJ-t vëmë re me lehtësi qëndrimin me dy standarde të PKJ dhe deformimin e fakteve. Rezoluta e Bujanit nuk merrte vendime për ndarjen e kufijve midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë në vitet e Luftës, nuk shtronte problemin e bashkimit “sot”, por që “sot” të luftohej kundër fashizmit, për të realizuar një aspiratë konkrete kombëtare “nesër”. Përse PKJ nuk e shpallte konkretisht këtë aspiratë për Kosovën, ashtu siç kishte bërë një muaj më parë në Konferencën e Dytë të AVNOJ-t, ku ishin miratuar vendimet e Këshillit NÇ të Kroacisë dhe të Këshillit NÇ të Sllovenisë për bashkimin me Kroacinë dhe Slloveninë të territoreve të shkëputura para Luftës së Dytë Botërore? Madje këto vendime të AVNOJ-t për zmadhimin e Jugosllavisë federative, “hynin menjëherë në fuqi”, pra që gjatë Luftës, në dallim nga vendimet e Bujanit, që e linin zgjidhjen pas Luftës.

Drejtuesit e PKJ, megjithëse kritikojnë, nuk artikulojnë gjithnjë hapur në letrën e 28 marsit 1944 se, çfarë prisnin nga Mbledhja e Bujanit. Megjithatë është një tjetër letër që e shpreh qartë qëllimin strategjik të udhëheqjes jugosllave, ajo që Mita Milkoviç, komisar politik i Brigadës shqiptare -maqedone në Maqedoni, ia dërgon udhëheqjes krahinore të

⁶³ Zekeria Cana, “Mbledhja e Mukjes, Lidhja e Dytë e Prizrenit, Konferenca e Bujanit dhe çështja e Bashkimit Kombëtar”, në *Studime historike*, Nr. 1-4, Tiranë: 1992, f. 102.

Kosovës: “Nuk është asgjëkund në Rezolutë, e formuluar në mënyrë të vendosur, se *Kosmeti duhet të qëndrojë në kuadrin e Federatës Jugosllavisë* (korsivi im-A.L.)”⁶⁴. Pikërisht se mungonte ky qëndrim në rezolutën e Bujanit dhe në rezoluta të tjera të mëparshme, komunistët shqiptarë të Kosovës ishin vënë në vazhdimësi në fokus të kritikës si “shqiptaromëdhenj”. Kjo kritikë bëhej sa herë që shqiptarët kërkonin ose shpreheshin për aspiratat e tyre kombëtare. Megjithëse parimi i vetëvendosjes i promovuar edhe nga Karta e Atlantikut edhe nga PKJ, linte shpresa për zgjidhjen e drejtë të problemeve etnike pas Luftës, e vërteta është që për shqiptarët e Kosovës shprehja e këtyre aspiratave u bë “mollë e ndaluar”. Ata që ngrinin zërin, barazoheshin me reaksionin. Nëpërmjet akuzave, PKJ synonte t’i detyronte shqiptarët të heshtnin, dhe të fitonte kohë deri në fund të luftës, kur të merrej pushteti. Nëse lexon dokumentet e viteve të Luftës në Kosovë, shihet se jo vetëm shqiptarët, por edhe Komiteti Krahinor i Kosovës akuzohet se “ka rënë nën ndikimin e klikës shqiptaromadhe”⁶⁵. Më 28 mars 1944 ky presion i vazhdueshëm u kthye në goditje.

Ka mendime se Konferenca e Bujanit ishte një utopi, tymnajë⁶⁶ etj. Këshillimi me dokumentet e kohës e bën të qartë se komunistët shqiptarë pranuan udhëheqjen e PKJ në Kosovë, por ata nuk ishin dy bashkëudhëtarë plotësisht të harmonizuar. Ndërsa në luftën kundër pushtuesve nazifashistë rruga e tyre ishte e përbashkët, për çështjen nacionale rrugët e tyre ndaheshin. Komunistët shqiptarë të Kosovës, synonin shpëputjen e Kosovës nga Jugosllavia, kurse udhëheqja e PKJ synonte ruajtjen e Jugosllavisë. Në Konferencën e Bujanit, komunistët shqiptarë e shfrytëzuan momentin. Për herë të parë ata u ndodhën në një forum drejtues krahinor në shumicë, përbërje kjo në përputhje me strukturën etnike të krahinës. Për rrjedhojë, Konferenca e Bujanit me vendimet e saj u shkau nga duart udhëheqjes së PKJ. Vendimet e marra në Bujan dëshmojnë edhe njëherë se komunistët e Kosovës e kishin shumë të hollë membranën ideologjike nën të cilën ndodhej një bërthamë e fortë nacionaliste. “Stalinizmi kosovar, shkruan prof. Arshi Pipa,

⁶⁴ *Zbornik..., Tom I, Knjiga 19*, dok. 152, f. 600. Letër e Mita Milkoviç dërguar Palokës (Pavle Joviçeviçit), sekretarit të KK të PKJ për Kosovën e Rrafshin e Dukagjinit më 26 korrik 1944.

⁶⁵ *Zbornik..., Tom II, Knjiga 10*, dok. 161, f. 339; *Po aty, Tom II, Knjiga 11*, dok. 71, f. 127.

⁶⁶ *Që historia shqiptare ..., f. 43.*

karakterizohet nga pragmtizmi, ideologjia këtu është një shtresë lustër. Gërvishteni atë dhe ju do të gjeni një kore të trashë nacionalizmi shqiptar, që është më e trashë dhe më e fortë se nacionalizmi në Shqipëri, pikërisht për arsye të ekspozimit të kosovarëve ndaj presionit nationalist të serbëve, malazezëve dhe më së fundi dhe të maqedonasve⁶⁷.

vijon në numrin tjetër të revistës

S u m m a r y

THE BUJAN'S CONFERENCE, DECEMBER 31, 1943-JANUARY 2, 1944, A REASSESSMENT

Even today, just 67 years since the Bujan's Conference has been summoned, the writings for it continue to be published. The authors come from the left and the right sides, different nationalities, historians, journalists, and politicians. The article considers the Bujan's Conference from several points of view: political, military, social, national and international. Article deals with the slogan of self-determination proclaimed by Antifascist Allies, the project of "Greater Albania" applied by German Nazi in Kosova, the specific national circumstances of the Kosovar people, which affected their participation in the Antifascist movement during WWII. There are analyzed the decisions of Bujan's Conference and it is explained why they are in the contrary with the AVNOJ conference. The ethnic ratio in the Bujan's Conference was in accordance with the ethnic structure of the people of Kosova. So, the majority of the participants in Bujan's Conference were Albanians and the decisions of the conference slid out of the Yugoslav leadership hands. But Tito made use of the right of the self-determination as long as he needed. At the end of the WWII and immediately after it, the Yugoslav leadership imposed on the Kosovars inclusion in Yugoslavia against their national aspirations.

⁶⁷ A. Pipa, *Stalinizmi...*, f. 258.

